

AKT NORMATIV
Nr. 37, datë 24.12.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË AKTIN NORMATIV NR. 8, DATË 7.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR SUBVENCIONIMIN E PAGESËS SË QIRASË SË BANESËS PËR FAMILJET E MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E FATKEQËSISË NATYRORE, TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Neni 7, i aktit normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 7

Subvencionimi i pagesës së qirasë, sipas këtij akti normativ, do të zgjasë deri në momentin që familjeve u rindërtohen apo rikonstruktohen banesat, të cilat, si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, janë shembur ose janë deklaruar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit."

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe